



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 2 prill 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1927\_2024

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47, Nenin 48, dhe Nenin 49 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 27 dhe 28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës Nr. 05/2017 për Vendosjen e Të Hyrave të Lejuara Maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Parimet për Përcaktimin të Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes;
- Vendimin V\_1923\_2024 të datës 22 mars 2024 për Të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH;
- Metodologjinë për Përcaktimin e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Propozimin e OSSH-së për aprovimin e Tarifave të Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datë 28 mars 2024,

në seancën e mbajtur më 2 prill 2024 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. APROVOHEN** - Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (Tarifa SHSSH), që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- II.** Struktura e tarifave për SHSSH që zbatohet nga OSSH është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të shpërndarjes		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€/kWh	0.76
10 kV	€/kWh	1.61
0.4 kV	€/kWh	2.42


**III.** Ky Vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) nga data 01 prill 2024 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.


## **A R S Y E T I M**


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 12 dhjetor 2023 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të Të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
  - ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i azhurnimeve vjetore të Të Hyrave dhe Tarifave për vitin relevant tarifor 2024, ka për qëllim të vendos Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarit OSSH, për periudhën 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025.
  - ZRRE me datë 22 janar 2024 nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) ka pranuar aplikacionin për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin relevant tarifor 2024.
  - ZRRE më datë 6 shkurt 2024 ka publikuar vlerësimin fillestar të aplikacionit lidhur me Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për të licencuarin KEDS Sh.A, ku i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
  - ZRRE më datë 21 shkurt 2024 ka pranuar komentet nga OSSH dhe palët e interesit lidhur me vlerësimin fillestar të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH.
  - Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH, përfshinë edhe të dhënat e përditësuara nga OSSH. ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka marrë në konsideratë përditësimet e bëra dhe çështjet e ngritura nga të gjitha palët e interesit në procesin e konsultimit publik.
  - ZRRE më 22 mars 2024 me anë të vendimit V\_1923\_2024 ka aprovuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për vitin relevant tarifor 2024.
  - ZRRE më datë 28 mars 2024 nga OSSH ka pranuar propozimin për Tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes.
  - Tarifat e propozuar nga OSSH janë kalkuluar në pajtueshmëri me Metodologjinë për Përcaktimin e ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes. Propozimi i OSSH për tarifat e OSSH është i bazuar në Vendimin e ZRRE-së për Të Hyrat e Lejuara Maksimale V\_1923\_2024 të datës 22 mars 2024.
  - Tarifat e propozuara nga OSSH, reflektojnë Të Hyrat e Lejuara Maksimale të aprovuara për OSSH.
  - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të propozimit për tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Shpërndarjes, ka vlerësuar se kërkesa është e bazuar në Vendimin V\_1923\_2024 të datës 22 mars 2024 për Të Hyrat e Lejuara Maksimale dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

  
\_\_\_\_\_  
Arta Isufi, anëtare

  
\_\_\_\_\_  
Adnan Preniqi, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KEDS,
- KESCO,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.